



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Statistikat e Transportit dhe Telekomunikacionit TM2 - 2017**



## Para thën i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për Transportin Rrugor, Hekurudhor, Ajror dhe Postë telekomunikimit. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore për periudhën TM 2 2017.

Duke u nisur nga kërkesa të vazhdueshme të shfrytëzuesve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm për të dhëna dhe informacione statistikore, dhe duke u bazuar në manualët dhe rekomandimet e EUROSTAT-it jemi munduar që përmes disa indikatorëve themelor të përgatisim një publikim për Statistika të Transportit dhe Telekomunikacion.

Qëllimi i publikimit është të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij sektori për ekonominë e vendit. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Burim i të dhënave të shfrytëzuara janë: Ministria e Punëve të Brendshme ( Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve të Kosovës), Ministria e Infrastrukturës - Drejtoria për rrugë, PTK (Post - telekomunikacioni i Kosovës), Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari “ - LIMAC si dhe Hekurudhat e Kosovës.

Ky publikim është përgatitur nga :

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit  
Ismajl Sahiti - Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike  
Hysni Elshani - Shef i sektorit të Statistikave Ekonomike  
Bekim Bojku - Zyrtar i Statistikave Ekonomike  
Ahmet Cakolli - Zyrtar për dizajn

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim i konsiderojmë të mirëseardhura.

Ueb faqja: [www.rks-gov.net/ask](http://www.rks-gov.net/ask) ose

E-mail adresa: [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

Korrik, 2017

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,  
z. Isa Krasniqi

## Përmbajtja

	Faqe
1. Metodologjia dhe përkufizimet .....	3
1.1. Metodologji .....	3
1.2. Mbulimi .....	3
1.3. Përkufizime .....	3
2. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara .....	4
3. Rrugët e Kosovës .....	5
4. Transporti Hekurudhor .....	7
5. Transporti Ajror .....	9
6. Telekomunikacioni (PTK-ja) .....	12
a. Kapaciteti i zyrave Postare .....	12
b. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë fikse .....	13
c. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë mobile (VALA) .....	14

## 1. Metodologjia dhe përkufizimet

### 1.1. Metodologji

Të dhënat janë administrative ku dhënës-it e informatave (të dhënave) janë Ministria e Punëve të Brendshme, Hekurudhat e Kosovës, Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës Adem Jashari, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës si dhe Ministria e Infrastrukturës - Drejtoria e Rrugëve të Kosovës.

### 1.2. Mbulimi

Të dhënat që janë shfrytëzuar për publikim janë nga viti 2011 deri në vitin 2016 për mjetet motorike dhe jo motorike, 2005 deri në tremujorin e dytë të vitit 2017 për transportin ajror dhe hekurudhor, kurse për PTK-ën janë nga viti 2009 deri në tremujorin e dytë të vitit 2017. Të dhënat për rrugët e Kosovës janë 2005 - 2016.

### 1.3. Përkufizime<sup>1</sup>

**Rrugë publike** - nënkupton sipërfaqen me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, e cila mund të shfrytëzohet nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent;

**Auto udhë** - nënkupton rrugën publike posaçërisht të ndërtuar dhe destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të shiritave me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autostradës, me gjerësi së paku 2,5 metra.

**Rrugë nacionale** - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;

**Rrugë rajonale** - nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve.

**Rrugë lokale** - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;

**Rrugë urbane** - nënkuptohet rruga publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune.

**Rrugë e pa kategorizuar** - nënkupton rrugë e cila nuk është caktuar si rrugë publike, por shfrytëzohet për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeve akumulues, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme.

---

<sup>1</sup>) Përkufizimet mbi rrugët janë marrë nga Ligji mbi rrugët (" Ligji nr. 03/L-120").

## 2. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara


Në vitin 2016 në Kosovë janë të regjistruara 319,615 mjete motorike dhe jo motorike apo 6.58% më pak se në vitin 2015.

Tab. 1. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Vetura</b>	170.321	176.398	222.537	236.145	281.847	260.291
<b>Automjet trans,3.5 dhe mbi 3.5t</b>	10.877	11.547	15.352	15.769	18.330	17.963
<b>Automjet trans,nën 3.5t</b>	17.901	18.225	24.659	26.949	30.846	31.285
<b>Kombibuset</b>	2.698	2.520	3.225	3.161	3.212	2.841
<b>Autobuset</b>	1.117	1.298	1.570	1.697	2.124	1.916
<b>Motoçikleta</b>	546	809	1.488	1.540	1.849	1.790
<b>Traktorë</b>	39	137	776	1.036	941	613
<b>Rimorkio nën3.5t</b>	101	117	217	250	286	288
<b>Rimorkio 3.5 dhe mbi 3.5t</b>	1.766	1.800	2.283	2.281	2.707	2.628
<b>Gjithsej</b>	<b>205.366</b>	<b>212.851</b>	<b>272.107</b>	<b>288.828</b>	<b>342.142</b>	<b>319.615</b>

Burimi i të dhënave: Ministria e Punëve të Brendshme

Graf. 1. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara



### 3. Rrugët e Kosovës

Që nga pas lufta e gjerë në vitin 2016 janë bërë investime kapitale në ndërtimin e rrugëve në Kosovë. Pasi që investimet janë në vijim, ende nuk është bërë ri klasifikimi i rrugëve. Klasifikimi i rrugëve, sipas standardeve të ndërtimit bëhet nga bordi i drejtorive përkatëse.

ASK-ja (Agjencia e Statistikave të Kosovës) nga Ministria e Infrastrukturës për vitet 2009 dhe 2010 ka marrë vetëm ndryshimet në gjatësinë e rrugëve Nacionale dhe Regjionale kurse duke filluar nga viti 2011 e këndej kemi filluar të pranojmë edhe të dhënat për kategorinë - Auto udhë. Kështu gjatë vitit 2011 kemi pasur gjithsej 38 km. Auto udhë të reja, në vitin 2012 kësaj i janë shtuar edhe 22.4 km. gjatë vitit 2013 po ashtu janë shtuar edhe 17.6 km. Auto udhë dhe në vitin 2016 janë shtuar 20 km. Auto udhë dhe tani gjatësia e Auto udhës<sup>2</sup> gjithsej është 98 km. Në vitin 2015 janë shtuar 10.3 km. rrugë Regjionale.


**Tab. 2. Rrugët e Kosovës sipas kategorive<sup>3</sup>**

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Autoudhë</b>	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	38,0	60,4	78,0	78,0	78,0	98,0
<b>Nacionale</b>	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4
<b>Regjionale</b>	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.305,0	1.305,0
<b>Totali</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.963,1</b>	<b>1.985,5</b>	<b>2.003,1</b>	<b>2.003,1</b>	<b>2.013,4</b>	<b>2.033,4</b>

Burimi i të dhënave: Ministria e Infrastrukturës

Sipas të dhënave të prezantuara vërehet se në vitin 2016 në territorin e Kosovës kemi 2,033.4 km, ku në kategorinë e rrugëve Auto udhë janë 5%, Nacionale 31% ndërsa 64% janë rrugë Regjionale.

**Graf. 2. Rrugët e Kosovës sipas kategorive**



<sup>2)</sup> Të dhënat për gjatësinë e Auto udhës janë marrë nga Ministria e Infrastrukturës.


<sup>3)</sup> Në këtë tabelë nuk janë të paraqitura rrugët komunale.

**Tab. 2a: Rrugët e Kosovës sipas kategorive - në kilometra (km)**

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Autoudhë</b>	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	38,0	60,4	78,0	78,0	78,0	98,0
<b>Nacionale</b>	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4	630,4
<b>Regjionale</b>	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.294,7	1.305,0	1.305,0
<b>Totali</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.925,1</b>	<b>1.963,1</b>	<b>1.985,5</b>	<b>2.003,1</b>	<b>2.003,1</b>	<b>2.013,4</b>	<b>2.033,4</b>

Burimi i të dhënave: Ministria e Infrastrukturës

Nga tabela e mësipërme vërehet se në vitin 2016 nga gjithsejtë 2.033,4 km rrugë 1.943,4 km apo shprehur në përqindje 95.6% janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 90 km apo 4.4% e rrugëve janë të pa asfaltuara.

**Graf. 2a. Struktura e rrugëve të Kosovës sipas kategorive**


#### 4. Transporti Hekurudhor

Në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 km binar hekurudhor për transport dhe 110 privat. Në hekurudhat e Kosovës qarkullojnë 8 lokomotiva Disell, ku bartin 27 vagonë, 9 të udhëtarëve dhe 18 për bagazh.

**Tab. 3. Kapaciteti hekurudhor, nga viti 2005 deri më TM – 2 / 2017<sup>4</sup>**

V i t e t	Numri i pasagjerve në mijë	Sasia e mallrave të transportuara në mijë ton	Sasia e mallrave të transportuara në milion ton - km.
2005	317,24	297,75	19,91
2006	401,49	356,65	23,80
2007	417,19	591,80	31,13
2008	338,88	823,05	48,87
2009	374,50	914,19	45,51
2010	376,77	1.129,01	66,69
2011	357,73	1.001,20	17,03
2012	366,55	826,33	48,58
2013	369,27	904,23	43,50
2014	339,58	848,15	39,02
2015	269,15	736,94	23,22
2016	279,21	249,67	7,85
TM 1-2011	83,29	173,11	0,00
TM 2-2011	98,61	247,81	0,00
TM 3-2011	97,44	288,31	17,03
TM 4-2011	78,40	291,97	0,00
TM 1-2012	87,94	173,46	13,09
TM 2-2012	96,00	152,23	6,95
TM 3-2012	94,85	231,18	13,02
TM 4-2012	87,77	269,47	15,51
TM 1-2013	82,35	220,81	8,47
TM 2-2013	95,59	281,59	10,80
TM 3-2013	98,91	171,05	12,20
TM 4-2013	92,41	230,78	12,04
TM 1-2014	91,04	158,26	6,58
TM 2-2014	90,87	227,38	7,75
TM 3-2014	75,42	317,91	15,42
TM 4-2014	82,25	144,61	9,27
TM 1-2015	66,67	200,65	3,49
TM 2-2015	70,63	204,46	6,72
TM 3-2015	65,84	172,79	7,00
TM 4-2015	66,02	159,03	6,00
TM 1-2016	61,43	79,41	1,99
TM 2-2016	82,69	21,54	0,88
TM 3-2016	70,65	14,83	0,48
TM 4-2016	64,43	133,89	4,49
TM 1-2017	51,98	97,91	3,25
TM 2-2017	56,76	132,58	4,39


<sup>4</sup> Për periudhën TM2 2016 është bërë revidimi i të dhënave tek Numri i udhëtarëve  
Burimi i të dhënave: Hekurudhate e Kosovës.




Në tremujorin e dytë të vitit 2017 numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rreth 57 mijë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017 numri i udhëtarëve është rritur për 9.19%.

Transporti i mallrave me tren në tremujorin e dytë të vitit 2017 është 132 mijë ton, në raport me tremujorin e parë të vitit 2017 (TM 1 2017) ka pasur rritje për 35.41%.

**Graf. 3. Numri i udhëtarëve sipas tremujorëve për vitet 2011 deri më TM - 2 2017 në mijë**



**Graf. 3a. Sasia e mallrave të bartura sipas tremujorëve për vitet 2011 deri më TM - 2/ 2017**



## 5. Transporti Ajror


Numri i fluturimeve në tremujorin e dytë të vitit 2017 është 1,767 apo 5.4 % më tepër se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM 2/2016).

**Tabela 4. Numri i fluturimeve sipas tremujorëve nga viti 2005 deri më TM-2/2017**

Vitet	TM 1	TM 2	TM 3	TM 4	Totali
2005	1,036	1,110	1,777	1,062	4,985
2006	885	934	1,408	853	4,080
2007	880	1,019	1,426	996	4,321
2008	997	1,108	1,662	1,161	4,928
2009	1,093	1,361	1,929	1,326	5,709
2010	1,250	1,431	1,961	1,501	6,143
2011	1,438	1,616	2,103	1,581	6,738
2012	1,424	1,648	2,197	1,678	6,947
2013	1,665	1,809	2,379	1,452	7,305
2014	1,232	1,431	1,941	1,390	5,994
2015	1,269	1,528	2,150	1,387	6,334
2016	1,433	1,676	2,174	1,564	6,847
2017	1,372	1,767			

Burimi i të dhënave: Aeroporti i Kosovës.

**Graf. 4. Numri i fluturimeve sipas tremujorëve**




**Tabela 4a. Numri i udhëtarëve sipas tremujorëve nga viti 2005 deri më TM – 2 / 2017 në mijë**

Vitet	TM 1	TM 2	TM 3	TM 4	Totali
2005	183	209	348	192	931
2006	172	205	325	180	883
2007	191	233	348	218	990
2008	233	263	387	249	1,131
2009	234	281	408	269	1,192
2010	261	298	450	297	1,306
2011	280	336	482	325	1,422
2012	293	366	530	339	1,527
2013	348	408	560	313	1,629
2014	271	344	472	318	1,405
2015	295	380	541	332	1,549
2016	350	426	573	394	1,744
2017	357	465			

Burimi i të dhënave: Aeroporti i Kosovës.

Numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar aeroplanin si mjet transporti është rreth 465 mijë, në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM 2 - 2016) kemi rritje për 9.15%.

**Graf. 4a. Numri i udhëtarëve sipas tremujorëve**

**Tab. 4b. Numri mesatar i udhëtarëve për një fluturim<sup>5</sup>**

Vitet	M u a j t											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2005	181	170	176	190	188	187	193	198	196	180	181	180
2006	185	197	204	228	218	213	230	232	232	215	206	212
2007	207	221	226	229	223	233	248	250	231	226	218	212
2008	218	234	249	248	232	234	239	239	215	217	215	210
2009	210	217	214	204	211	205	217	217	196	202	198	208
2010	208	206	211	210	205	209	239	230	216	208	195	192
2011	193	195	196	206	206	212	240	233	210	209	199	207
2012	203	196	217	225	218	223	244	248	228	212	192	201
2013	201	210	217	223	223	230	232	245	225	220	207	219
2014	209	221	231	240	236	244	235	256	236	226	227	234
2015	231	229	238	249	252	246	244	263	246	239	239	241
2016	236	247	251	262	261	241	267	271	251	254	248	254
2017	247	263	272	254	260	274						

<sup>5</sup> Numri mesatar i udhëtarëve është kalkuluar nga numri i udhëtarëve për muaj në raport me numrin e fluturimeve për muaj.

## 6.Telekomunikacioni (PTK-ja)


### a. Kapaciteti i zyrave Postare

**Tab. 5. Numri i zyrave postare të shfrytëzuara dhe të pashfrytëzuara**

Posta	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Zyrat Postare	134	177	177	177	177	177	177	177
Zyrat postare të shfrytëzuara	130	166	166	166	166	166	166	166
Zyrat postare të pa shfrytëzuara	4	11	11	11	11	11	11	11

Burim i të dhënave Posta dhe Telekom i Kosovës

**Graf. 5. Numri i zyrave postare të shfrytëzuara dhe të pa shfrytëzuara**



## b. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë fikse

Tab. 5a. Përdoruesit dhe Impulset

Telefonia fikse	Numri i telefonave fiks		Gjithësej	
	Mesatarja e kapaciteteve ekzistuese në mijë për tre muaj	Mesatarja e kapaciteteve të shfrytëzuara në mijë për tre muaj	Mesatarja e parapagusve në mijë për tre muaj	Numri i impulsave në milion për tre muaj
TM 1 -2009	222,2	74,6	74,6	80,7
TM 2 -2009	222,2	74,6	74,6	77,4
TM 3 -2009	222,2	83,3	83,3	53,7
TM 4 -2009	222,2	77,5	77,5	70,6
TM 1 -2010	222,2	76,5	76,5	73,0
TM 2 -2010	222,2	76,8	76,8	70,5
TM 3 -2010	222,2	82,8	82,8	56,7
TM 4 -2010	222,2	80,7	80,7	67,9
TM 1 -2011	222,2	78,4	78,4	65,3
TM 2 -2011	222,2	78,9	78,9	63,6
TM 3 -2011	222,2	82,4	82,4	59,7
TM 4 -2011	222,2	83,9	83,9	65,3
TM 1 -2012	222,2	86,2	86,2	35,4
TM 2 -2012	222,2	85,4	85,4	34,2
TM 3 -2012	222,2	84,5	84,5	34,2
TM 4 2012	222,2	85,4	85,4	34,6
TM 1 2013	222,2	81,3	81,3	32,1
TM 2 2013	222,2	82,4	82,4	32,3
TM 3 2013	222,2	83,5	83,5	33,2
TM 4 2013	222,2	79,4	79,4	27,4
TM 1 2014	222,2	77,7	77,7	24,5
TM 2 2014	222,2	76,4	76,4	24,0
TM 3 2014	222,2	74,7	74,7	22,6
TM 4 2014	222,2	72,8	72,8	21,0
TM 1 2015	222,2	71,4	71,4	18,3
TM 2 2015	222,2	70,1	70,1	19,1
TM 3 2015	222,2	70,6	70,6	18,4
TM 4 2015	222,2	70,7	70,7	18,6
TM 1 2016	222,2	71,4	71,4	18,3
TM 2 2016	222,2	48,6	48,6	12,8
TM 3 2016	222,8	47,6	47,6	13,6
TM 4 2016	222,8	48,1	48,1	13,4
TM 1 2017	222,8	45,1	45,1	11,4
TM 2 2017	222,8	43,9	43,9	7,8


Burim i të dhënave Posta dhe Telekom i Kosovës.

**c. Përdoruesit dhe Impulset e telefonisë mobile (VALA)**
**Tab. 5b. Kapaciteti instalues dhe shfrytëzuesit e telefonisë mobile vala në tremujorin e dytë 2017**

Tremujori	Pri-Paid në mijë	Post-Paid në mijë	Totali i shfrytëzuar i telefonisë mobile VALA në mijë
TM 4 -2010	926.89	49.75	976.64
TM 1 -2011	900.66	49.92	950.58
TM 2 -2011	904.70	49.67	954.36
TM 3 -2011	958.88	45.77	1,004.64
TM 4 -2011	956.69	45.23	1,001.92
TM 1 -2012	908.04	45.67	953.71
TM 2 -2012	904.69	36.05	940.74
TM 3 -2012	970.01	36.24	1,006.25
TM 4 -2012	927.58	39.32	966.90
TM 1 -2013	927.58	39.32	966.90
TM 2 -2013	929.52	34.84	964.35
TM 3-2013	917.07	34.85	951.92
TM 4 -2013	914.62	36.33	950.95
TM 1 -2014	867.36	30.79	898.15
TM 2 -2014	840.04	29.73	869.76
TM 3 - 2014	863.62	28.10	891.72
TM 4 - 2014	854.73	28.56	883.29
TM 1 - 2015	820.31	29.13	849.44
TM 2 - 2015	797.89	29.62	827.51
TM 3 - 2015	867.88	24.67	892.55
TM 4 - 2015	828.70	27.92	856.61
TM 1 - 2016	935.91	39.45	975.36
TM 2 - 2016	943.08	39.62	982.70
TM 3 - 2016	963.16	40.02	1,003.18
TM 4 - 2016	904.61	44.91	947.33
TM 1 - 2017	1,190.72	50.85	1,241.57
TM 2 - 2017	904.72	44.91	949.65

Burim i të dhënave Posta dhe Telekom i Kosovës

**Graf. 5b. Shfrytëzuesit Pri-Paid dhe Post-Paid**





# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politikë, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>